



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P.564/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin me pikë të ofertave të operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., dhe BOE “Artyka II” sh.p.k. & “Vashtemia” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65744-07-16-2020, me objekt: “Loti 9, Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbllak – Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë ”, me fond limit 169,973,967 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Artyka II” sh.p.k. & “Vashtemia” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k.
Lagjia nr.3, Shëtitore Europa, Pogradec.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rr. “Sami Frashëri”, nr.33, Tiranë.

Subjekte të interesuara:

BOE “Artyka II” shpk & “Vashtëmia” shpk
Rr. Nationale Korçë-Pogradec Km 1

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga BOE ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 17.07.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-65744-07-16-2020, me objekt: “Loti 9, Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec -

Plasë ”, me fond limit 169,973,967 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 8451/1 datë 06.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 07.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatoët si më poshtë.

- Rej I kualifikuar
- Jubica I skualifikuar
- Igma I skualifikuar
- Vashtëmia I kualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 09.09.2020 me shkresën nr.4794/9 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 30.09.2020 ora 13:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

Artyka II&Vashtëmia 151,689,203.42
Rej 152,997,953.16

II.4. Në datën 02.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. BOE “Artyka II&Vashtëmia”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	151,689,203.42	100	100	100	300
2	151,689,203.42	100	100	100	300
3	151,689,203.42	100	100	100	300

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 300 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i	Oferta	Pikët për	Pikët përvoja	Pikë cilësia	Total në %
-----------	--------	-----------	---------------	--------------	------------

KVO-së	ekonomike	cmimin në %	në punë e kompanisë në %	metodologjia makineri etj	
1	151,689,203.42	60	20	20	100
2	151,689,203.42	60	20	20	100
3	151,689,203.42	60	20	20	100

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 100 pikë.

2. Rej shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	152,997,953.16	99	75	75	249
2	152,997,953.16	99	75	75	249
3	152,997,953.16	99	75	75	249

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 249 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4
2	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4
3	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 89.4 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	Artyka II&Vashtëmia	300	100
2	Rej	249	89.4

II.5. Në datën 12.10.2020 operatori ekonomik ankimes "Rej" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me vlerësimet me pikë të ofertave të paraqitura, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga BOE "Artyka II" sh.p.k. & "Vashtemia" sh.p.k., duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Ne, në rradhë të parë, pretendojme se vlerësimi me 268.2 pikë i ofertës së shoqërisë tonë nuk është mbështetur në parimin e ligjshmërisë dhe objektivitetit. Në rradhë të dytë, nuk është mbështetur edhe në metodologjinë dhe sistemin e pikëzimit të deklaruar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar dokumenteve të përmendura më sipër të procedurës së prokurimit, nga ana e autoritetit tuaj kontraktor, si kriter i përcaktimit të ofertës fituese është përzgjedhur "Oferta Ekonomike më e Favorshme". Ku nga ju është përcaktuar se kriteret do të peshohen me pikë si më poshtë vijon:

oferta ekonomikisht më e favorshme X

*lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë
etj. pikë*

Kriteret e Vleresimit Pikët

- (i) Çmimi më i ulët (0-60) Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.*
- (ii) Pervoja në pune e kompanisë (10-20) Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punët e realizuar në formë CV, shoqëruar me vertetim punimesh, të kryera në 10 viteve të fundit.*
- (iii) Cilësia (0-20) Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi,*

Më konkretisht në konstatojmë se keni përcaktuar që cilësia do të vlerësohet me 20 pikë, si edhe keni parashikuar se për këtë kriter, vlerësimi do të bëhet mbështetur në: Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar, për elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Në, në përmbushje të kriterit të mësipërm, kemi dorëzuar dokumentin: "Metodologji, plani i organizimit të punës dhe plani i menaxhimit të sigurisë në punë". Ky dokument, i dorëzuar nga ana jonë, është i përbërë nga 130 faqe dhe përbëhet nga 6 krerë. Në Kreun I kemi përshkruar Qëllimin e punës, përshkrimin e shkurtër, personelin, makineritë dhe paisjet, planin e organizimit të kantierit, listën e plotë dhe të detajuar të dokumenteve që do të përgatiten gjatë zbatimit të kontratës, përshkrimin e punimeve periodike dhe të rehabilitimit, cilësisë së materialeve dhe planit të sigurisë në punë. Vetëm me Kreun I të ofertës sonë teknike në kemi superuar të gjithë elementët e përcaktuar nga ana juaj për vlerësimin e ofertës,

Më tej, një pjesë të posacme i kemi kushtuar qëllimeve dhe kushteve të punës si edhe sigurimit teknik në punë dhe mbrotjes së mjedisit. Duke analizuar në detaje edhe komponentë si menaxhimi i aksidenteve dhe ndihma e shpejtë, vlerësimin e rriskut dhe mbrotjes së mjedisit. Në Kreun IV kemi analizuar në detaje metodologjinë e punimeve. Duke përfshirë ato të mirëmbajtjes dhe ato rutinë, referuar si termave të referencës të publikuar nga autoriteti juaj kontraktor, por edhe vlerësimin teknik në terren të kryer nga ana e inxhinierëve tanë. Gjithashtu, një të posacme i kemi kushtuar

KTZ (Kushtet Teknike të Zbatimit të Punimeve) dhe së fundmi edhe plani të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në nenin 31, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Par miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.”

Në rastin konkret, ne vlerësojmë se shoqëria jonë në aspektin cilësor ka paraqitur një propozim teknik më të detajuar dhe të thelluar, duke tejkaluar minimumin e elementëve të kërkuar nga ana e autoritetit tuaj kontraktor.

Në lidhje me personelin dhe pajisjet, referuar propozimit tonë teknik, ne kemi deklaruar: për zbatimin e kësaj faze planifikohen burimet njerëzore të nevojshme si më poshtë:

Inxhinier Ndertimi 1

Inxhinier Mekanik 1

Inxhinier Gjeoteknik/Ndertimi 1

Inxhinier Gjeolog 1

Teknik 1

Operator per Makinerite e Renda 8

Inxhinier i Sigurimit Teknik 1

Oficer i Sigurimit Teknik 1

Mekanik 2

Shoferi 8

Punetore te Specializuar 7

Punetore 20

Makineri dhe pajisje

Per realizimin e punimeve se objektit parashikohen te nevojshme makinerite, mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

1. Mjet transporti veteshkarkues mbi 8 tone

2. Grejder

3. Rrul vibrues

4. Prerese asfalti

5. Freze asfalti

6. Betoniere

7. Autobot uji

8. Autobitumatrice

9. Asfaltoshtruese

10. Motomjet ose Agregate per prerjen e bimesise se ulet

11. Kamioncine deri ne 3.5 tone

12. Minieskavator
13. Minifadrome (Bobcat ose ekuivalent)
14. Fadrome
15. Eskavator me zinxhire
16. Eskavator me goma
17. Makineri per vijezim rrugor
18. Mjet (Batipal) per vendosje parrakesh metalik(Guardrails)
19. Fabrike Asfaltbetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore
20. Borepastruese (APV) ose Agregate per pastrim bore me kamion ne dispozicion (kamion + rruspe + shperndarres kripe) Cope 3

Në lidhje me stafin teknik, shoqëria jonë ka propozuar angazhimin e 52 punonjësve. Ndëkohë, bazuar në dyshime të arsyeshme si edhe duke marrë në konsideratë kapacitetin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, vlerësojmë se nuk mund të kenë angazhuar më shumë se 30 punonjës në nivel inxhinierësh dhe staf teknik mbështetës. Pra shoqëria jonë ka deklaruar të paktën 1.5 herë më shumë se sa bashkimi i operatorëve ekonomikë që janë vlerësuar me pikë maksimale.

Sa më sipër, vlerësojmë se propozimi ynë teknik duhet të vlerësohet me pikë maksimale, me 20 pikë.

Gjithashtu, bazuar në dyshime të arsyeshme, si edhe duke njohur kapacitetin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ARTYKA II” shpk & “VASHTEMLIA” shpk vlerësojmë se propozimi teknik në drejtim të cilësisë, nuk mund të vlerësohet me pikë maksimale. Vlerësojmë se pikëzimi i kryer nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është subjektiv, si edhe nuk është mbështetur as në analizën e thelluar të propozimit tonë: as në analizën krahasimore midis dy propozimeve teknike.

Qartazi propozimi ynë është më i favorshmi dhe më i detajuari. Duke dhënë kështu garancitë e plota jo vetëm për zbatimin me sukses të kontratës, por edhe të cilësisë së kryerjes së punimeve. Për të cilën ju si autoritet kenë përzgjedhur dhe ofertën ekonomike më të favorshme në drejtim të përcaktimit të ofertës fituese. Ju si autoritet nuk mund të vlerësoni objektivisht dhe në mënyrë të cekët propozimet teknike. Por duhet të mermi në konsideratë elementët konkretë të deklaruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Sa më sipër, kërkojmë pikëzimin tonë me pikë maksimale për zërin e “Cilësia”, me 20 pikë, si dhe rishikimin e pikëzimit të dhënë me 20 pikë për bashkimin e Operatorëve Ekonomikë ARTYKA II dhe VASHTEMLIA. Duke e vlerësuar proporcionalisht me më pak pikë, ndjeshëm, krahasuar me ofertën tonë, si oferta më e favorshme.

Së dyti, në lidhje me përvojën e kompanisë të kryer në 10 vitet e fundit, në dokumentet e procedurës është parashikuar vlerësimi me 20 pikë.

Në rradhë të parë, ne nënvizojmë se Shoqëria “REJ” shpk, e themeluar me 9 mars 1994 me Vendim Gjykatë nr. 3321 me ndryshimet e mëvonshme nr. 21636 date 09.07.1999 ortak të vetëm, është person juridik shqiptar, me seli administrative në Tiranë dhe filiale përfaguesuese e ushtrim veprimtarie në disa qytete të vendit. Ndërkohë, nga verifikimet e kryera në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ARTYKA II” shpk është themeluar në 13.02.2002. Kjo do të thotë se shoqëria jonë gëzon 7 vite më shumë eksperiencë se sa anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të përmendur. Në lidhje me dëshminë e eksperiencës, sqarojmë se vetëm gjatë viteve 2005-2007 shoqëria jonë ka zbatuar punime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë me objektin e procedurës së prokurimit, në vlerën fresh 188.975,814 lekë pa TVSH të deklaraura në CV e kompanisë si më poshtë vijon:

Ndertim Zyra U. Kanalizime Sh.a.

Sistemim kanalizim ndricim dhe asfaltim Blloku Kala

Rikonstruksion, ndricim Spitali Pogradec

Ndertim shkolle 8-vjecare Cerrave+Lunik

Ndertim i mureve mbajtes ne Varrezat ekzistuese Pogradec

Sistemim, kanalizime UZ, asfaltim Blloku Rinia qyteti Pogradec

Ndertim kanali ujites Hudenisht

Rikonstruksion rruga Hotolisht

Ndërkohë, në vitet 2007-2008 kemi realizuar punime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë në vlerën rreth 69.520,000 leke pa TVSH të deklaruara në CV e shoqërisë.

Ndërsa, në vitet 2008-2009 kemi realizuar punime të së njëjtës natyrë me zërat e punimeve të procedurës së prokurimit në masën rreth 31,264,849 lekë pa TVSH.

Në periudhën 2009-2011, e cila përfshihet edhe në periudhën e dhjetë vjecarit të fundit, për efekt të vlerësimit, kemi realizuar punime të së njëjtës natyrë me zërat dhe me elementët konkretë të procedurës prokurimit, rreth vlerës 261,571,650 leka pa TVSH. Ndërkohë, per periudhën 2012-2013, e cila përfshihet edhe në periudhën e dhjetë vjecarit të fundit, për efekt të vlerësimit, kemi realizuar punime të së njëjtës natyrë me zërat dhe me elementët konkretë të procedurës prokurimit, rreth vlerës 119,937,302 leka pa TVSH. Për vitin 2014, kemi realizuar punime të së njëjtës natyrë me zërat dhe me elementët konkretë të procedurës prokurimit, rreth vlerës 99.624,179 leka pa TVSH. Ndërkohë, në 5 vjeçarit e fundit, 2015-2020 shoqëria jonë ka realizuar punime të së njëjtës natyrë me zërat dhe me elementët konkretë të procedurës prokurimit, rreth vlerës 1,992,137,947 leke pa TVSH.

Pra, në total, shoqëria jonë, vëtëm në 10 vitet e funnit ka dëshmuar eksperiencë të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit mbi 20 milion dollarë.

Ndërkohë, në lidhje me shoqërinë “VASHTEMIA” shpk, pasi morëm në analizë buletinet e Njoftimeve Publike të viteve të fundit, konstatojmë se kjo shoqëri është shpallur fituese në 9-10 procedura si anëtar bashkim operatorësh me vlerë punimesh reth 1 milion euro në kontrata si: Sistemim asfaltim Maliq, Sistemim Asfaltim i rrugëve rurale, Sistemim Asfaltim i Njësive Administrative Maliq, Rikonstruksion i rrugëve Fshati Barc, Sistemim në fshatin Oman, si të vetmen kontratë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Ndërkohë shoqëria ARTYKA II disponon një numer shumë të vogël kontratash. Konkretisht në Buletinet e APP-së, sa ne kemi parë, rezulton se kjo shoqëri nuk ka më shumë se 5 kontrata të ngjashme në Rajonin Jugor me vlerë maksimale prej 1 milion euro. Pra, të dy shoqëritë së bashku nuk disponojnë as sa kapaciteti i kontratave të ngjashme të shoqërisë tonë.

Sa më sipër, vlerësojmë se në lidhje me dëshminë e eksperiencës së ngjashme, shoqëria jonë duhet të vlerësohet me pikë maksimale, me 20 pikë.

Sa më sipër analizuar, ne kërkojmë rishikimin e vlerësimit me pikë maksimale prej 20 pikë për shoqërinë “ARTYKA II” shpk & “VASHTEMIA” shpk.

Vlerësojmë se pikëzimi i kryer nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është subjektiv, nuk është mbështetur as në analizën e thelluar të dëshmisë së eksperiencave të shoqërisë të ngjashme të së njëjtës natyrë, përfshirë si në vlerë ashtu dhe në natyrë-punimesh midis dy propozimeve. Ku qartazi propozimi ynë përmban eksperiencë më të gjatë, konstante dhe me vlerë disa herë më të madhe se sa bashkimi i operatorëve e ekonomik të kualifikuar me pikët maksimale.

Theksojmë, se Ju si autoritet nuk duhet të vlerësoni subjektivisht dhe në mënyrë të cekët propozimet teknike. Por duhet të merrni në konsideratë elementët konkretë të dekluar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sa më sipër, ne kërkojmë pikëzimin tonë me

pikë maksimale për zërin e "Eksperiencia", me 20 pikë, dhe rishikimin e pikëzimit të dhënë me 20 pikë për bashkimin e Operatorëve Ekonomikë ARTYKA II dhe VASHTEMLIA. Duke e vlerësuar proporcionalisht me më pak pikë, ndjeshëm, krahasuar me ofertën tonë, si oferta më e favorshme.

Në lidhje me ofertën ekonomike, kërkojmë të kryhet pikëzimi vlerësuar në metodologjinë e deklaruar dhe të llogjikshme. Pra oferta e deklaruar/ oferta më e ulët X 60 pikë. Pasi kemi dyshime të arsyeshme se vlerësimi nuk është bërë në përputhje me sa më sipër cituar.

Sa më sipër, ne kërkojmë edhe rishikimin e vlerësimit me pikë të ofertës tonë duke e vlerësuar me pikë maksimale, si dhe rishikimin e pikëve për bashkimin e shoqërisve "ARTYKA II dhe VASHTEMLIA" shpk. Duke e vlerësuar me më pak pikë, në mbështetje sa më sipër sqaruar,

Gjithashtu, kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik "ARTYKA II" shpk ka paraqitur dokument te parregullt dhe te fallsifikuar per Vertetim Taksa Vendore nga Bashkia Devoll per vitin 2019. kerkojme nga AK verifikimin e autenticitetit te ketij dokumenti dhe verifikimin prane bashkise Devoll[...]"

II.6. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k., me anë të shkresës nr.7645/1prot., datë 19.10.2020, duke mos e pranuar atë, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

II.7.Në datën 26.10.2020, operatori ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8.Në datën 10.11.2020 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.8451/1prot., datë 06.11.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik", në të cilin parashikohet se "1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre", Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, gjatë trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik Rej shpk, duke vendosur mospranimin e ankesës me pretendimin se është paraqitur jashtë afatit.

Sa më sipër Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 02.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

3. BOE “Artyka II&Vashtmia”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	151,689,203.42	100	100	100	300
2	151,689,203.42	100	100	100	300
3	151,689,203.42	100	100	100	300

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 300 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	151,689,203.42	60	20	20	100
2	151,689,203.42	60	20	20	100
3	151,689,203.42	60	20	20	100

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 100 pikë.

4. Rej shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	152,997,953.16	99	75	75	249
2	152,997,953.16	99	75	75	249
3	152,997,953.16	99	75	75	249

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 249 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4
2	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4
3	152,997,953.16	59.4	15	15	89.4

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 89.4 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	Artyka II&Vashtëmia	300	100
2	Rej	249	89.4

III.1.2. Në datën 12.10.2020 operatori ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me vlerësimet me pikë të ofertave të paraqitura, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga BOE "Artyka II" sh.p.k. & "Vashtëmia" sh.p.k.

III.1.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k., me anë të shkresës nr.7645/1prot., datë 19.10.2020, duke mos e pranuar atë, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 3, 5, 6 të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar është parashikuar: "*Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin*".

2. *Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

3. *Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.*

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.1.5. Në rastin konkret, nga verifikimet e kryera, rezulton se procesi i vlerësimit të operatorëve ekonomikë ka përfunduar më datë 02.10.2020. Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 12.10.2020.

Neni 63 pika 2 e LPP parashikon shprehimisht se: Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Referuar datës së vlerësimit me pikë dhe datës së dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor mbi vlerësimin e ofertës teknike, KPP konstaton se ankimi i operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. është paraqitur brenda afatit 7 ditor nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, dhe ky i fundit legjitimohet *ratione temporis*.

Konkretisht referuar në legjislacionin si më sipër cituar, nisja e afatit për paraqitjen e ankesës për shkeljen e pretenduar pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës. Duke pasur parasysh që dita e vlerësimit të ofertave data 02.10.2020 ka qenë ditë e premte, dita e nesërme e punës në kuptim të parashikimit ligjor nga e cila nis afati i numërimit për të paraqitur ankesë pranë autoritetit përkon me ditën e hënë datë 05.10.2020. Pra nga ky moment data 05.10.2020 nis dhe afati i numërimit për paraqitjen e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe përfundon ditën e shtate 11.10.2020. Por sërish dita e shtatë 11.10.2020 përkon me ditë pushimi dhe në kuptim të nenit 56 të KprA në të cilin parashikohet shprehimisht se “Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati. 3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. 4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Sa më sipër afati për paraqitjen e ankesës pranë KPP shtyhet ditën pasardhëse të punës që përkon pikërisht me datën 12.10.2020 datë në të cilën është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik Rej shpk. Në këtë kuptim KPP gjykon se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Rej shpk pranë autoritetit kontraktor si dhe pranë KPP –se është brenda afateve ligjore.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të KVO lidhur me vlerëimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Procedurë e kufizuar*” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

III.2.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.2.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore

Faza 1 – Parakualifikimi: *Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Faza 2 - Ftesa për Ofertë: *Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.*

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët**

Ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) **Çmimi më i ulët**

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Pervoja ne pune e kompanise

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) Cilësia

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.2.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimi të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Rej shpk në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka parqitur formularin e ofertës në vlerën 152,997,953.16 lekë pa tvsh. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja ne pune e kompanisë- Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit, Rej shpk ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- Kontratë lidhur midis Komuna Udenisht dhe shoqëria “Rej” shpk me objekt Sistemim Asfaltim i rrugës lart fshati Memelisht Komuna Udenisht me vlerë 33,399,912 lekë. Formular Vlerësimi
- Kontratë lidhur midis Komuna Udenisht dhe shoqëria Rej 3 shpk me objekt Sistemim sheshiqendër Udenisht Rruga Nacionale me vlerë 24,978,157 lekë pa tvsh. Formular Vlerësimi.
- Kontratë lidhur midis Ujësjiellës Kanalizime Tiranë shpk dhe JV Rej&Igor Elektrik me objekt Rikonstruksion i kolektorit të ujrave të zeza 2x1000 në rrugën Shyqyri Demneri dhe rikonstruksion ujësjiellësi DN-80 mm me vlerë 9,933,768 lekë pa tvsh. Rej shpk 70%. Formular Vlerësimi.

- Kontratë Sipërmarrje lidhur ndërmjet Komuna Trebinjë dhe Rej shpk me objekt Rikonstruksion i shkollës së mesme Trebinje me vlerë 10,763,740 lekë me tvsh. Formular Vlerësimi.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.91/5 datë 11.12.2012 lidhur ndërmjet Bashkia e Tiranës dhe BOE Rej shpk& Vashtëmia me objekt Rikonstruksion i rrugës Xhemal Tafaj, me vlerë 23,863,455 lekë me tvsh. Formular Vlerësimi vlera e realizuar 22,732,644 lekë me tvsh. Rej shpk 58.4%.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.7430/4 datë 31.03.2017 lidhur ndërmjet Bashkia e Tiranës dhe BOE Albin Tros 2011&Rej shpk me objekt Asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Mushqeta me vlerë 26,998,613 lekë me tvsh.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.89/5 datë 11.12.2012 lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe Rej shpk&Vashtëmia me objekt Rikonstruksion i rrugës 28 Nëntori në përputhje të plotë me projektzbatimin e objektit me vlerë 26,279,316 lekë me tvsh. Formular Vlerësimi. Rej 60%.
- Kontratë Nr.809 datë 19.09.2014 lidhur ndërmjet Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes me objekt Loti 1 Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së MM me vlerë 41,269,942 lekë pa tvsh Loti II me objekt Rikonstruksion i nyjeve sanitare në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes me vlerë 6,974,707 lekë pa tvsh. Shtesë kontrate me vlerë 4,425,890 lekë pa tvsh. Vërtetim realizimi.
- Kontratë lidhur ndërmjet Bashkia Pogradec dhe BOE Rej shpk&Shpresa shpk me objekt Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të pogradecit me vlerë 198,062,504 lekë me tvsh.Vërtetim realizimi (vlera e realizuar 156,067,772 lekë pa tvsh).
- Kontratë Punimesh Nr.209 prot datë 28.04.2015 lidhur ndërmjet Bordi Kullimit Tiranë dhe Rej shpk me objekt Mbrojtja nga grryerja e tokës kanali Peqin me vlerë 10,646,772 lekë pa tvsh.Formular Vlerësimi.
- Kontratë lidhur ndërmjet Bashkia Maliq dhe Rej shpk me objekt Rikonstruksion i cative dhe fasadave të objekteve në rrugën kryesore të qytetit Maliq me vlerë 34,566,710 lekë pa tvsh.Formular Vlerësimi.
- Kontratë Sipërmarrje lidhur midis Dia Vita dhe Rej shpk me objekt Punime ndërtimore në kantierin e ndodhur pranë Spitalit Rajonal Korçë me vlerë 37,951,861 lekë. Formular Vlerësimi.
- Kontratë me objekt N/stacion lëvizës në Himarë lidhur ndërmjet OSHEE dhe BOE Rej shpk&CR Teknology System SPA me vlerë 196,700,000 lekë pa tvsh.Vërtetim Realizimi. (Rej shpk 20%).
- Kontratë me objekt Pajisje për likudimin e avarive OSHEE dhe BOE Rej shpk&CR Teknology System SPA me vlerë 191,700,000 lekë pa tvsh. (Rej shpk 20%). Vërtetim Realizimi.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Prrrenjas për objektin e kontratës Ndërtimi i Linjës së Ujësjellësit nga burimi i ujit në galerinë 1070 deri në depo uji Varovë Skroske me vlerë të realizuar 6,638,103 lekë me tvsh. Kontrata.
- Kontratë nr.4016 prot datë 29.08.2016 lidhur ndërmjet Bashkia Maliq dhe Rej shpk me objekt Kanali ushqyes i rezervuarit Petrushë, Podgorie+Kanali ujitës i Kombinatit Maliq, me vlerë 34,116,852 lekë pa tvsh. Formular Vlerësimi.
- Kontratë lidhur ndërmjet OSHEE sha dhe BOE Igor Elektrik&Rej shpk me objekt Rikonstruksion i Fiderit 17 Fajancë-Voskopojë ndërtim i rrjetit TU me kabëll të tipit ABC në qytetin e Bilishtit dhe fshatin Pojan me vlerë 74,491,187 lekë pa tvsh. Formular Vlerësimi . Rej shpk 89.34%.

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e OSHEE sha Korcë për objektin e kontratës Loti 1 Linja Tu me përcjellës ABC kabina Vashtëmi 1 Vashtëmi 2 me vlerë të realizuar 15,990,566 lekë me tvsh.Rej shpk 66%.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Korcë për objektin e kontratës Loti 2-Linja TU me përcjellës ABC kabina Lumalas 1 Lumalas 2. Rej shpk 66%.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Korcë për objektin e kontratës Loti 3-Linja TU me përcjellës ABC kabina Bulgarec 1,2,3,4 dhe Kabina Stacioni i Pompave Bulgarec dhe rikonstruksioni i kabinave. Rej shpk 66 %.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Korce për objektin e kontratës Loti 4-Linja TU me përcjellës ABC kabina Qytet Maliq me vlerë të realizuar 28,648,452 lekë me tvsh. Rej 60%.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për objektin e kontratës Sistemim Rrugësh Blloku Goricë me vlerë 68,194,112.3 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për objektin e kontratës Rehablitim përforcim banesash ekzistuese me vlerë 23,676,231 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për objektin e kontratës për një shtesë fondi tek objekti Sistemim rrugësh Blloku Goricë, me vlerë të realizuar 13,144,368 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për objektin e kontratës Për një shtesë fondi tek objekti Sistemim rrugësh Blloku Goricë me vlerë 13,144,368 lekë me tvsh.
- Kontratë shërbimi Nr.767/6 prot datë 25.02.2020 lidhur ndërmjet Bashkia Pogradec dhe Rej shpk me objekt Vazhdim i shërbimit të pastrimit grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisve administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara me vlerë 53,068,996 lekë me tvsh. Vërtetim Realizimi
- Kontratë Nr.6 me objekt Mbrojtje nga lumi Devoll Ura Zëmlak dhe Diga lidhur ndërmjet Dretoria e Ujitjes dhe Kullimit Korcë dhe Rej shpk me vlerë 9,339,514 lekë pa tvsh.
- Kontartë Nr.5532/1 prot datë 20.07.2018 lidhur ndërmjet Bashkia Pogradec dhe Rej shpk me objekt Sistemim rrugësh blloku Goricë me vlerë 68,194,693.68 lekë. Formular Vlerësimi.
- Kontratë me objekt Blerje Transformatorë fuqie për nevojat e OSHEE sha lidhur ndërmjet OSHEE dhe BOE Rej shpk&CR Teknology System spa me vlerë 195,000,000 lekë pa tvsh. Vërtetim Realizimi. Rej shpk 20%. Formular Vlerësimi.
- Kontratë me objekt Zgjerimi i fiderit 20 kv për në zonën industriale me linjë kabllore nëntokësore ndërtim kabina të reja tip Box si dhe ndërtim rrjeti TU Kavajë, lidhur ndërmjet OSHEE dhe BOE Kola Invest &Rej shpk me vlerë 42,600,771 lekë pa tvsh. Marrëveshje Nënkontraktimi. Formular Vlerësimi. Rej 49%.
- Kontratë Sipërmarrje Nr.3584/4 prot datë 30.01.2017 lidhur ndërmjet Drejtoria Rajonale Shkodër dhe BOE Igor Elektrik&Rej shpk me objekt Ndërtim i fiderit të ri Bajzë dhe kabinës shtyllore Gjeke Mucaj si dhe i rrjetit ABC, me vlerë 6,443,953 lekë pa tvsh.
- Kontratë Punimesh lidhur ndërmjet Rej Energy shpk dhe Rej shpk me objekt Punime gërmimi , punime ndërtimi për objektin Hec Cemerica 1,2,3, me vlerë 50,546,677 lekë me tvsh. Formular Vlerësimi.
- Kontratë Nr.8256 prot datë 27.11.2019 lidhur ndërmjet Bashkia Pogradec me Rej shpk me objekt Rehabilitim/përforcim banesash ekzistuese me vlerë 19,730, 193 lekë pa tvsh. Formular Vlerësimi.

- Kontratë Nr.433/2 prot datë 03.06.2016 lidhur ndërmjet Bordi Rajonal i Kullimit dhe Rej shpk me objekt Mbrojtje në segmentin Pularia –Qafa e Breshërit në Lumin Kalasë Delvinë me vlerë 38,537,000 lekë pa tvsh.
- Kontratë Nr.7210/4 datë 03.11.2016 me objekt Furnizim Vendosje Sistemi Automatik Dedektimi dhe shuarje zjarri me CO2 për Gjeneratorët e Agregateve lidhur ndërmjet KESH sha dhe BOE Rej&CR Technology spa.
- Metodologji , Plani i Organizimit të Punës dhe Plani i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Ndërkohë parë në rafsh krahasimor dokumentacioni i ofertuesit BOE “Artyka II” shpk & “Vashtëmia” shpk KPP vëren se ky i fundit në funksion të komponentit lidhur me eksperiencën e ngjashme ka paraqitur si vijon:

- Formular Vlerësimi për kontratën me objekt ndërtim ambulance tip A1 Fshati Ecmënik me vlerë të realizuar 1,413,468 lekë.
- Certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve për kontratën me objekt Sistemin i disa rrugëve të brendshme në fshatrat Miras , Menkulas dhe Poncarë me vlerë 2,919,720 lekë
- Formular Vlerësimi për kontratën me objekt Betonim Përoi Fshati Cipan me vlerë të realizuar 1,175,040
- Formular Vlerësimi për kontratën me objekt Asfaltim i rrugës Baban_Stropan me vlerë 24,798,360
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës ndërtim shkolle CU fshati gracë me vlerë 6,537,864 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i sallës së mbledhjeve Komuna Hocisht me vlerë 1,161,640 lekë .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës ndërtim shkolle e mesme fshati Miras me vlerë të realizuar 14,519,496 lekë.
- Certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve për kontratën me objekt Rikonstruksion Qendër shëndetësore fshati baban me vlerë 3,945,168 lekë.
- Certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve për kontratën me objekt Rikonstruksion shkolla fshati hocisht, me vlerë 6,467,154 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion në zyrat e komunës miras me vlerë 6,710,124 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë Rutine+Dimërore me vlerë 15,817,824 lekë
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruge të brendshme fshati Cipan me vlerë 10,252,632 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë Rutinë Dimërore (kontrata shtesë) aksi rrugor komuna liqenas dogana Goricë 16 km me vlerë 1,563,840 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion rrjeti i jashtëm i ujësjellësit të fshatit Verlen me vlerë 22,441,200 lekë.

- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të fshatit baban me vlerë 23,994,300 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës ndërtim shkollë 9 vjecare fshati Vidohovë me vlerë 22,172,208 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë e aksit rrugor bilisht miras me vlerë të realizuar 3,177,240 lekë .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë+dimërore rruga K/podgoricë Koritë +rruga Koritë-K/Liqenas 20 km me vlerë 15,586,246 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga hociht grace me vlerë 26,991,480 lekë.
- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë aksi rrugor K/Liqenas Dogana Goricë 16 km me vlerë të realizuar 16,234,128 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rrugë të brendshme fshati Maliq me vlerë të realizuar 35,979,042 lekë me tvsh.
- Akt Marrje në dorëzim për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rrugë të brendshme fshati Maliq Bashkia Maliq Kontratë shtesë me vlerë 5,930,862 lekë me tvsh.
- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës mirëmbajtje dhe pastrim nga dëborë i rrugëve rurrale me vlerë të realizuar 8,397,000 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion sistemi asfaltim i rrugës Petrushë Vreshtas me vlerë 105,568,320 lekë. Artyka II 22,633,847 lekë.
- Akt Marrje në dorëzim për objektin e kontratës Rehabilitim i rrugës së fshatit Cangonj me vlerë 115,711.9 euro.
- Vërtetim realizimi për objektin Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga K/ Podgorie K/Liqenas+rruga Bilisht-Miras 35 km me vlerë 66,209,568 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor K/Liqenas-Dogana Goricë 16.4 km me vlerë 16,518,564 lekë me tvsh.
- Akt Marrje në dorëzim për objektin Mirëmbajtje dhe pastrim nga dëborë i rrugëve rurrale me vlerë 7,992,000 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës ndërtim ujësjellësi fshati Strelcë me vlerë 10,431,796 lekë me tvsh. Artyka II shpk 12.95%.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Devoll për objektin e kontratës Rehabilitim i kanalit ujtitës të fushës së Bilishtit Kanali Bracanaj Vishocicë me vlerë 23,913,558.2 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara në Bashkinë Devoll me vlerë 14,329,221.64 lekë me tvsh.
- Akt marrje në dorëzim për objektin Mirëmbajtje e rrugëve rurrale gjatë periudhës së dimrit me vlerë 11,772,000 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rehabilitim i rrugëve në njësinë administrative Miras me vlerë 29,396,580 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim i ujësjellësit Stropan Devoll me vlerë 29,600,894.82 lekë pa tvsh
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara me vlerë 14,246,313.6 lekë me tvsh.

- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga K/Zemblak-K/Liqenas+rruga K/Liqenas-Dogana Goricë +rruga Libonik Rëmbec.. me vlerë 35,493,988 lekë me tvsh. Artyka II 51%. Vashtëmia 49%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Bilisht Vernik Loti I me vlerë 38,745,853.58 lekë me tvsh. Artyka II 49%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga Kryqëzim rruga nacionale deri në fshatin Klocë Faza III me vlerë 15,190,284 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Ndërtim i rrugës së Boboshticës me vlerë 24,270,960 lekë me tvsh
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë dhe dimërore Aksi rrugor Korcë Q.Pllocë me vlerë 10,634,064 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës ndërtim i brendshëm i ujësjellësit dhe KUZ lagjia Qesaratë me vlerë 13,734,550 lekë pa tvsh
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Kanalizimi i ujrave të zeza Fshati Vishovicë Komuna Qendër Bilisht me vlerë 12,513,720 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Leminot Faza e I-rë me vlerë 23,505,000 lekë me tvsh.
- Vërtetim realizimi për objektin Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë aksi rrugor K/Zemblak K/Liqenas 16 km me vlerë 10,783,558 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim i Rrugës Kryqëzim Vithluq Lubonjë deri tek ura e gurtë me vlerë 35.251,806 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore aksi rrugor Korcë Petrushë me vlerë 22,584,528 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore aksi rrugor Korcë Kapshticë 36 km me vlerë 19,977,562 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Asfaltim rrugë të brendshme fshati Sheqeras dhe qyteti Maliq me vlerë 8,674,934 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Impjant për therjen e bagëtive dhe përpunimin e mishit plus zyra dy katëshe me vlerë 41,379,980 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga hyrëse Vlocisht rrugë dytësore Libonik dhe ambiente sportive të shkollave 9 vjecare Libonik Vashtëmi me vlerë 13,094,633.28 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës KUB dhe KUZ fshati Vreshtas Lagjia e Proit qyteti Maliq dhe KUB shkolla Sheqeras Bashkia Maliq me vlerë 7,827,612 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku sheshi i poliklinikës sheshi i xhamisë sheshi i pazarit rruga e mborjes rruga e ravonikut me vlerë 282,602,669 ALL. Vashtëmia 17%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Kanalizimi i ujrave të zeza fshati Maliq me vlerë 1,818,840 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rehabilitimi i rrugës hyrëse Pylli i Fazanëve Maliq me vlerë 17,396,340 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me vlerë 3,924,180 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim Maliq dhe njësitë administrative faza I me vlerë 25,254,552 lekë. Vashtëmia 62%.

- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim i rrugës hyrëse fshati Bulgarec me vlerë 7,759,128 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga kryqëzimi i rrugës Korcë Bilisht me vlerë 105,014,148 lekë . Vashtëmia 20%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga Pogradec Korcë dhe kontrata shtesë me vlerë 41,437,193.5 lekë . Vashtëmia 54.4%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale me vlerë 48,751,943 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Stallë lopësh 1 kat me vlerë 19,206,764 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim Maliq dhe Njësitë Administrative Faza III me vlerë 4,150,070.4
- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga K/Boboshticë-dardhë-Rryga Korcë-Voskopojë 35 km me vlerë 40,862,390 lekë me tvsh. Vashtëmia 18%.
- Vërtetim Realizimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim Maliq+Njësitë Administrative me vlerë 26,019,816 lekë me tvsh. Vashtëmia 85%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim Maliq dhe Njësitë Administrative me vlerë 2,599,992 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale fshati Barc me vlerë 11,688,816 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga Vaskavë faza e parë me vlerë 13,828,452 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim i rrugës hyrëse në fshatin Zvirinë me vlerë 13,270,194 lekë me tvsh. Vashtëmia 46.7%.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga hyrëse fshati Zvirinë faza II me vlerë 6,722,536.8 lekë me tvsh.
- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga K/Zemblak-K/Liqenas.... me vlerë 35,493,998 lekë me tvsh .
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë e dimërore aksi rrugor Korcë Q pllocë me vlerë 10,634,064 lekë me tvsh.
- Vërtetim realizimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë e dimërore aksi rrugor K/Zemblak K/Liqenas 16 km me vlerë 10,783,558 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë e dimërore aksi rrugor Korcë Petrushë 25 km me vlerë 22,584,528 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë e dimërore aksi Korcë Kapshticë 36 km me vlerë 19,977,562 lekë.
- Formular Vlerësimi për objektin e kontratës Mirëmbajtje me performancë rutinë e dimërore rruga Pogradec Korcë rruga Pogradec Dogana Tushemisht 41.3 km dhe kontratë shtesë me vlerë 41,437,193.5 lekë me tvsh. Vashtëmia 54.4 %.
- Punime mirëmbajtje të realizuara gjatë vitit 2018

III.2.5. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kriterëve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik Rej shpk në veprimtarinë e tyre shfaqin një eksperience të konsiderueshme në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit dhe sistemimit të rrugëve. Me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik dëshmon se ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlera të konsiderueshme e si rrjedhojë pretendimi i tij për një vlerësim sa më afër kufirit maksimal lidhur me komponentin eksperiencë e ngjashme , është i bazuar.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që cdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” është plotësuar më së miri nga operatori ekonomik Rej shpk. Vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësisimit të Ofertave në rastin konkret nuk është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik Rej shpk pasi vlera e kontratave të ngjashme të realizura është tepër e lartë e cila meriton një pikëzim sa më afër maksimales.

Ndërkohë sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik Rej shpk për rishikim të pikëve të BOE Artyka II&Vashtëmia shpk lidhur me komponentin e eksperiencës së ngjashme KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë shfaq një eksperiencë shumë të gjatë e të thelluar në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit si dhe të mirëmbajtjes së rrugëve e rrjedhimisht vlerësimi me 20 pikë i këtij bashkimi është tërësisht i drejtë e i justifikuar me dokumentacionin e paraqitur nga ky i fundit. KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik shfaq një avantazh më tepër në funksion të plotësimit sa më mirë të komponentit eksperiencë e ngjashme pasi provon se ka realizuar kontrata jo vetëm të një natyre të ngjashme me objektin por edhe të njëjtë në një sasi të konsiderueshme. Në këtë kuptim KPP gjykon se pikëzimi për këtë bashkim operatorësh lidhur me këtë komponent nuk duhet të ndryshojë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Rej” shpk qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Rej shpk për një vlerësim maksimal të komponentit të tretë të përcaktuar në dokumentatat e procedurës së prokurimit objekt ankimi e konkretisht “Cilësia” KPP vëren se:

Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur procedurën e “Kufizuar” në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si edhe ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertën ekonomike më të favorshme në kuptim të nenit 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643

datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në përcaktimin e ofertës fituese ka përzgjedhur tre komponentë, ccmimi më i ulët i cili referuar dokumentave të procedurës së prokurimit zë 60 % të peshës së vlerësimit, (ii) Pervoja në punë e kompanisë e cila zë 20 % të peshës së vlerësimit dhe cilësia e cila zë gjithashtu 20 % të peshës së vlerësimit. Në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.3.1. Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar që të përzgjedhë në përputhje me nenin 55 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: cmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 55 të ligjit për prokurimin publik, ku *inter allia* shprehet se *oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.*” Gjithashtu, edhe në nenin 31 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar se *“Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.”* Sa më sipër, në respekt të nenit 55 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 31 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret e përcaktimit të ofertës fituese si edhe të japë peshë specifike me një sistem të posacëm pikëzimi.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (eksperiencia e ngjashme ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kycc të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (racio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të

ofertës fituese si oferta e konomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas cmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit, zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 20 % të pikëve cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

III.3.2. Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në vlerësimin e metodologjisë së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të punës, zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerjes së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, ri organizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomike më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Rej” shpk, rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me 15 nga 20 pikë maksimale të metodologjisë. Metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga 6 seksione:

- Hyrje
- Qëllimi dhe kushtet e punës
- Sigurimi teknik në punë dhe mbrojtja e mjedisit
- Metodologjia e punëve (mirëmbajtje rutinë-punime rehabilitimi)
- Kushtet teknike të zbatimit të punimeve
- Metodologjitë e punimeve.

III.3.3. Nga seksionet e mësipërme, tre nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës në drejtim të sigurimit teknik në punë dhe

mbrojtjes nga mjedisi, metodologjinë e punimeve të mirëmbajtjes, kushtet teknike të zbatimit të punimeve dhe planimit të menaxhimit të sigurië dhe shëndëtit në punë.

Nga ana tjetër, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Vashtemia” shpk & “ARTYKA II” shpk, përbëhet nga:

- Grafiku i punimeve
- Metodologji për mirëmbajtje rutinë vepra arti
- Metodologji asfalti
- Metodologji mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt
- Metodologji për mbushje dhe nivelim të bankinave
- Metodologji për pastrimin e karrazhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera
- Metodologji për pastrimin e kanaleve dhe kunetave
- Metodologji për pastrimin e tombinove
- Metodologji për pastrimin e vegjetacionit
- Metodologji për punime betoni e betone arme
- Metodologji për punime shtresash rrugore
- Metodologji për riparimin e gropave të asfaltit
- Metodologji punime emergjence
- Metodologji sinjalistike horizontale dhe vertikale
- Sinjalistika e menaxhimit të trafikut gjatë punimeve rrugore
- Skema e organizimit të stafit

III.3.4. Në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë është paraqitur një metodologji e përgjithshme në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” shpk i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës. Në metodologjinë e punimeve për punime mirëmbajtje rutinë “pastrim i karrazhatës nga avulionet dhe materialet e tjera”, ndër të tjera bashkimi i operatorëve ekonomikë “Vashtemia” shpk & ARTYKA” shpk ka deklaruar se “ *Në rastet kur kemi depozitime ose shkarje të mëdhëna që mund të jetë burim aksidentesh, bëhet bllokim i rrugës dhe njoftohen instacat përkatëse “Policia e qarkullimit, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë”, ku ndërkohë referuar dokumenteve të kryerjes së shërbimit, vendi i kryerjes së shërbimit është Rajoni Qendror, Segmenti rrugor sipas objektit të Lotit IX. Sa më sipër, KPP vlerëson se metodologjia e propozuar është hartuar referuar një procedurë tjetër prokurimi dhe jo procedurës konkrete. Kështu, në metodologjinë e operatorit ekonomik “Rej” shpk në lidhje me planin e organizimit të kanterit është parashikuar ndër të tjera se: “ *Plani I organizimit të kantierit do të konsistoje në ngritjen e ambienteve të pershtatshme për zyra dhe ndihmen e shpejte. Ngritjen e nyjeve sanitare dhe vend depozitimeve të sigurt. Qarkullimi i mjeteve do të bëhet në mënyrë të tillë që të mos pengojë lëvizjen normale të mjeteve në rrugët aksesuese për në objekt. Kantieri do të mbahet në kushte të mira higjienike. Me përfundimin e Kontrates, të gjitha ndertesat e lehta do të hiqen dhe zona do të lihet e pastër dhe në rregull. Mirëmbajtja Dimorore: Do të kryejmë alokim të borepastrueseve në 3 pika. 1 me vendndodhje në Libonik. 1 me vendndodhje në Rrembec. 1 me vendndodhje në Diellas. Kjo shpërndarje është bërë për të patur një efektivitet dhe një barazlartësi të zonave që do mbulohe duke patur parasysh që një borepastruese i takon afërsisht 15 km rrugë për pastrim. Mirëmbajtja rutine: Do të ngrihet një kantier i vogël në Rrembec dhe Diellas, ndërsa kantieri kryesor do të jetë në Libonik.”* Ndërkohë nga ana tjetër nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Vashtemia” shpk & “Artyka” shpk*

është parashikuar: Rezervat e kripës / rërës do të jenë në kantieri i subjektit Vashtemia shpk me adrese : Rruga Nationale Korce Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale dhe ne kantieri i subjektit Artyka II shpk me adrese : Rruga e Mirasit, Km.i I, Prane Ish Nyjes se Inerteve, Bilisht”.

Në nivel krahasimor, dallueshëm nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk është paraqitur një metodologji e detajuar, me dy kantiere mbështetëse dhe një kantier kryesor të propozuar për t’u ngritur duke patur të barazlanguar secilën pikë nga 15 km, në ndryshim nga bashkimi i operatorëve ekonomikë që ka propozuar dy kantiere.

Në lidhje me grafikun e propozuar të kryerjes së punimeve, nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk është deklaruar si më poshtë vijon:

Nje vemendje te vecante do te marre dhe percaktimi i kohes se kryerjes se punimeve te rehabilitimit. Stafi teknik ka perpiluar grafikun e punimeve (i paraqitur sebashku me dokumentacionin tjeter teknik si pjese e ketij propozimi) do ti vihet ne dispozicion Mbikqyresit te Punimeve qe ne javet e para mbas nenshkrimit te kontrates. Grafiku jep informacion ne lidhje me punet qe do kryhen si dhe kohen kur do fillojne dhe perfundojne punimet rehabilituese. Per perpilimin e grafikut te punimeve, stafi teknik i shoqerise do te marre ne konsiderate kushtet e rruges, te metat qe ajo paraqet, ndikimin qe keto te meta kane ne gjendjen e rruges dhe se si ndikojne ato te drejtuesi i mjetit, nevojen emergjente qe kane keto te meta per tu riparuar si dhe kushtet klimaterike qe priten ne vazhdim te zbatimit te kontrates.

Nje parashikim i grafikut te punimeve, bazuar ne eksperiencen e shoqerise tone, do te jete si me poshte:

} Riparimi/mbushja e te gjitha gropave ne sipërfaqen e rruges – brenda 2 muajve nga nenshkrimi i kontrates.

} Vendosja e sinjalistikes vertikale dhe barrierave mbrojtese – brenda 2 muajve nga nenshkrimi i kontrates.

} Punime te shtresave asfaltike – faza e pare nga muaji 3 deri ne muajin 5 si dhe faza e dyte nga muaji 10 deri ne 13.

} Sistemimi i skarpateve, punimet te tjera te shtresave asfaltike, punimet per sinjalistiken horizontale – nga muaji 6 deri ne muajin 9 nga nenshkrimi i kontrates.

} Stabilizimi i reshqitjeve te dherave ne rruge (pastrimi i tyre, ndertimi i mureve te thjesht mbajtes) – brenda 2 muajve nga nenshkrimi i kontrates.

} Riparimet e bankinave (mbushje, ngjeshje, nivelim), pastrimi i kanaleve te drenazhit, riparim dhe pastrim i kunetave (riparime nepermjet punimeve te betonit) – nga muaji 3 deri ne muajin 5 nga nenshkrimi i kontrates.

} Punimet per strukturat beton arme – nga muaji 10 deri ne muajin 11 nga nenshkrimi i kontrates / Punimet per veprat e artit (ndertim mure gabion, tombino rrethore, bordura) nga muaj 11 deri ne muajin 12 nga nenshkrimi i kontrates.

Vetekuptohet qe punimet per Mirembajtjen Rutine dhe Dimerore do te zgjasin pergjate gjithë afatit 48 mujor te kontrates. Eshte e kuptueshme qe parashikimi i mesiperm, mund te ndryshoje si pasoje e kushteve te motit ose nga dukuri te tjera te paparashikuara megjithate, ne cdo rast, stafi teknik i shoqerise do te bashkepunoje ngushte me Mbikqyresin e Punimeve persa i perket grafikut te

punimeve rehabilituese per te pershpejtuar ose vonuar kryerjen e nje punimi sipas rekomandimeve te Mbikqyresit apo Autoritetit Kontraktor

III.3.5. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues “REJ” shpk konstatohet se punimet kryesore të shtresave asfaltike, të skarpateve, të riparimit të bankainave si edhe të strukturave beton arme dhe të punimeve të veprave të artit do të kryhet në një kohë më të shpejtë, pra brenda 12 muajve në total nga nga lidhja e kontratës, ndërkohë, në grafikun e zbatimit të punimeve nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Vashtemia” shpk & “Artyka” shpk janë deklaruar se këto punime do të shtrihen gjatë 48 muajve, ndërkohë që punimet e asfaltimit dhe të vijëzimit nuk do të kryhen gjatë periudhës së mirëmbajtjes dimërore. Në drejtim të kohëzgjatjes së zbatimit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është parashikuar kryerja e punimeve (përvec mirëmbajtjes) brenda 12 muajve krahasimisht ndjeshëm me bashkimin e operatorëve ekonomikë “VASHTEMLIA” shpk & “ARTYKA” shpk e cila është deklaruar se do të kryhet brenda 48 muajve.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “REJ” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka analizuar në detaje një metodologji mbi programin e monitorimit ambiental, ku ndër të tjera ka deklaruar se: *“ Programi I Monitorimit Ambientale Aktivitetet monitoruese duhet te perfshijne kontrollin e ndotjes se ajrit dhe zhurmave bazuar ne VKM n.103 dt 31/03/2002 “Mbi monitorimet mjedisore te dy parametrat “Treguesit e gjendjes mjedisore” ne lidhje me “ajrin urban” 1. Monitorimi I ndotjes se ajrit Kontrolli I ndotjes se ajrit duhet te kryhet me ane te vendosjes se disa aparateve mates te multi parametrave qe punojne ne menyre te panderprere dhe te pajisur me transmetues te dhenash, te cilat do te ruhen ne kontrollin e autoritetit perkates. Pajisja duhet te vendoset ne afersi te kantierit,dhe te monitoroj nivelet e ndotjes ne afersi te zones se punes dhe perreth saj. Ne rastet kur vlerat e ndotjes do te jene me te larta se norma e percaktuar/e lejuar nga autoritetet monitoruese mjedisore, duhet te merren masa mbrojetese perkatese. 2. Monitorimi i ndotjes akustike ne zonat e operimit dhe perreth saj Ndotja akustike do te kontrollohet nepermjet ‘fonometrave’ te pajisur me transmetues te dhenash njesoj si pajisjet e matjes se ndotjes se ajrit. Keto pajisje do te vendosen pergjate zones dhe ne limitet ekstreme te rrugeve dhe ndertesave perreth. Ne rast te niveleve te larta te ndotjes akustike,nje barriere e pershtatshme do te adoptohet prane zones ku punohet qe te parandaloj ndotjen.*

Konkretisht, KPP vlerëson se në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, operatori ekonomik “REJ” shpk ka ofruar mbështetje teknike me një plan të detajuar mbi uljen e nivelit të ndotjes së mjedisit të zonave ku do të kryhen punime si edhe të zonave përreth, ndërkohë që nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Vashtemia” shpk & “Artyka” shpk nuk ka një plan të detajuar të menaxhimit mjedisor.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë një analizë të detajuar në rrafshin krahasimor mes dy metodologjive, KPP gjykon se metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik “Rej” shpk duhet vlerësuar me pikët maksimale, ndërsa metodologjia e propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Vashtemia”shpk & “ARTYKA” shpk me një vlerësim ndjeshëm më të ulët se sa ajo e operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Gjithashtu nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi *“Njoftimin e Fituesit”* në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si edhe në bazë të informacionit të autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi rezulton se në datën 27.10.2020 është nënshkruar Marrëveshja Kuadër nr.4797/31 prot midis ARRSH dhe BOE Artyka II&Vashtëmia.

Në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.*

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”,

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.4.2. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”*

Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se *“ Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.”*

Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se *“ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.*

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke refuzuar ankesën e tij. Me refuzimin e ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe dhënia e një vendimi të arysetuar nga ky i fundit nuk heq pezullimin e procedurës së prokurimit parashikuar nga neni 63 pika 3 e LPP. Autoriteti kontraktor

ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduralë të ankimit duke vijuar me hapat e mëtejshëm të publikimit të njoftimit të fituesit, brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimes i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes ka qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë K.P.P si në momentin e publikimit të njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit gjithashtu edhe në momentin e dorëzimit të ankesës pranë KPP.

III.4.4. Vendimi i autoritetit kontraktor për publikimin e njoftimit të fituesit si edhe vendimi për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me lidhjen e kontratës është një akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) si *do shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*". Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (*domethënjën e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), gjykon se ndodhet para kushtet e konstatimit *prima facia* të një akti administrative absolutisht të pavfleshëm dhe në cilësinë e organit administrative më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 19/1 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" të ndryshuar, konstaton se aktet administrative të publikimit të njoftimit të fituesit dhe të lidhjes së kontratës të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convallescere non potest);

Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se "*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*" autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për kthimin e palëve në gjendjen juridike fillestare.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Rej shpk *Gjithashtu, kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik "ARTYKA II" shpk ka paraqitur dokument te parregullt dhe te fallsifikuar per Vertetim Taksa Vendore nga Bashkia Devoll per vitin 2019. kerkojme nga AK verifikimin e autenticitetit te ketij dokumenti dhe verifikimin prane bashkise Devoll[...]*", KPP gjykon se ky është një pretendim i cili është ngritur jashtë afatit të lejuar ligjor pasi verifikimi i këtij kriteri i takon fazës së parë të parakualifikimit (short listing).

Sa më sipër pretendimi i mësipërm nuk merret në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65744-07-16-2020, me objekt: “Loti 9, Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbllak – Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë ”, me fond limit 169,973,967 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrative “Njoftim Fituesi” të BOE Artyka II&Vashtmia” si akt i nxjerr në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji.
4. Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme për kthimin e palëve në gjendjen juridike fillestare.
5. Autoriteti kontraktues brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” shpk
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr. 1346 Protokoli, Datë 26.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtares së Komisionit të Prokurimit Publik znj. Enkeleda Bega (Nënkryetar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtare e KPP shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përse i përket ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k., konkretisht nuk jam dakord me arsytimin në pikën III.1.7 të arsytimit, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin me pikë të ofertave të operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., dhe BOE “Artyka II” sh.p.k. & “Vashtemia” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65744-07-16-2020, me objekt: “Loti 9, Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë”, me fond limit 169,973,967 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kriterëve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik “Rej” shpk nuk demonstroi të këtë eksperiencë në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore në përputhje me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur ky operator dëshmon se ka realizuar me së shumti kontrata me objekt rikonstruksion të objekteve civile, por shumë pak në fushën e infrastruktures rrugore, të cilat konsiderohen të ngjashme me natyrën e kontratës objekt ankimi. KPP vëren se nga tërësia e eksperiencave të paraqitura, operatori ankimues “Rej” shpk nuk arrin të dëshmojë se ka eksperiencë në fushën e mirëmbajtjes.

Komisioni gjykon se procesi i vlerësimit me pikë është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ankimes. Fryma e LPP është e tillë që cdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore nuk është plotësuar në maksimumin e mundshëm nga operatori ekonomik “Rej”shpk e rrjedhimisht pretendimi i tij për një pikëzim maksimal lidhur me këtë komponent nuk është i bazuar.

Ndërkohë sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik Rej shpk për rishikim të pikëve të BOE Artyka II&Vashtëmia shpk lidhur me komponentin e eksperiencës së ngjashme KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë shfaq një eksperiencë shumë të gjatë e të thelluar në fushën e rikonstruksionit, ndërtimit si dhe të mirëmbajtjes së rrugëve e rrjedhimisht vlerësimi me 20 pikë i këtij bashkimi është tërësisht i drejtë e i justifikuar me dokumentacionin e paraqitur nga ky i fundit. KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik shfaq një avantazh më tepër në funksion të plotësimit sa më mirë të komponentit eksperiencë e ngjashme pasi provon se ka realizuar kontrata jo vetëm të një natyre të ngjashme me objektin por edhe të njëjtë në një sasi të konsiderueshme. Në këtë kuptim KPP gjykon se pikëzimi për këtë bashkim operatorësh lidhur me këtë komponent nuk duhet të ndryshojë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Rej shpk nuk qëndron.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, gjykoj:

Të mos pranohet ankesa e operatorit ekonomik “Rej”sh.p.k. për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65744-07-16-2020, me objekt: “Loti 9, Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbllak – Liqenas - Dog. Goricë, Libonik - Rrëmbec - Plasë”, me fond limit 169,973,967 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nënkryetar
Enkeleda Bega